



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

DEKRET
PËR
KTHIMIN E LIGJIT NR. 9713, DATË 16.04.2007
“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8560, DATË 22.12.1999
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”.

Në mbështetje të neneve 85 dhe 93 të Kushtetutës

Dekretoj

Kthimin për rishqyrtim edhe njëherë në Kuvend të ligjit nr.9713, datë 16.04.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Nr. Dekretit 5288
Tiranë, më 08.05.2007

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
ALFRED MOISIU

(Signature)



Republika e Shqipërisë
Presidenti i Republikës

Motivimi i kthimit të ligjit nr. 9713, datë 16.4.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”

Të nderuar deputetë,

Në datë 20.04.2007 më ka ardhur për shpallje ligji nr. 9713, datë 16.4.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, të cilin, në bazë të nenit 85, paragrafi 1 të Kushtetutës, vendosa të mos e shpall por ta kthej edhe njëherë për rishqyrtim në Kuvend.

E vlerësoj të rëndësishëm ligjin, i cili ka parashikuar në vetvete disa rregullime më të mira në raport me ato të ligjit egzistues. Me qëllim që procedura e miratimit të ligjit të lehtësohet sadopak, pas kthimit të tij nga ana ime, çmoj se duhet t’ju shpjegoj sa më konkretisht, shkaqet që më çuan në kthimin e ligjit për rishqyrtim në Kuvend.

Arsyeja, për të cilën nuk e dekretova këtë ligj, lidhet me dispozitën e nenit 43, paragrafi 2 i tij. Kështu, neni 43, paragrafi 2 i ligjit ka këtë formulim: “Para se të paraqiten për shqyrtim gjyqësor, tatimpaguesit janë të detyruar të paguajnë 15 për qind të çdo gjobe dhe interesi. Shqyrtimi gjyqësor i çështjeve zhvillohet sipas një procedure gjyqësore të përshpejtuar, e cila nuk duhet t’i kalojë 60 ditë”.

Ky rregullim, sipas vlerësimit tim, bie ndesh me disa dispozita kushtetuese. Konkretisht, me nenin 11, që lidhet me parimin se sistemi ekonomik në Republikën e Shqipërisë bazohet në ekonominë e tregut dhe se prona private mbrohet njëllor me ligj; me nenin 42 që ka të bëjë me garantimin për të mos cënuar liritë dhe të drejtat e njoitura në Kushtetutë na një proces të rregullt

Sipas gjykimit tim, ligji nuk ka bërë dot mirë dallimin mes detyrimit tatimor dhe dënimit administrativ, që vjen për shkak të shkeljes së ligjit, të prezumuar, për subjektin tatimor, përsa i perket detyrimit për parapagimin e tyre përpara fillimit të procedurave ankimore. Edhe pse kjo, në vija të përgjithshme është e përcaktuar saktësisht në ligj, përsëri, zgjidhja e gjetur nuk eviton sa më lart. Jam dakort me logjikën e përdorur për parapagimin e detyrimit tatimor përpara fillimit të ankimit administrativ të aktit administrativ. Logjika e kësaj qëndron në faktin se shteti duhet t'a marrë të drejtën e tij në kohë dhe se përfundimi që arrihet në këtë rast nga organi tatimor është i bazuar mbi një veprimtari të caktuar paraprake. Gabimi, në eventualitetin e tij, sjell pasojën sipas ligjit që shteti kthen shumën e marrë padrejtësisht, së bashku me interesat përkatëse. Por kjo logjikë nuk mund të funksionojë në mënyre të njëjtë, qoftë dhe pjesërisht, sikurse e parashikon neni 43, paragrafi 2, me dënimin administrativ. Dënimi administrativ është gjoba e cila është disafish e vlerës së detyrimit tatimor. Edhe pse ligji i ardhur për shpallje parashikon se parapaguhet jo e gjithë gjoba, por, 15 për qind e saj, para se të paraqitet ankimi në gjykatë, çmuj se ky rregullim cënon disa dispozita kushtetuese

Së pari, prish parimin e një procesi të rregullt ligjor. Individit detyrohet me ligj që të paguajë, pjesërisht dënimin administrativ, i cili nuk është i njëjtë me detyrimin tatimor, përpara se ligjshmëria e këtij dënimi të verifikohet nga gjykata. Nëse do paguhet 15 për qind, 50 për qind apo 100 për qind, kjo është çështje konvencionale dhe vullneti i cili mund të ndryshojë në çdo kohe në qoftë se do të pranohej që parapagimi paraprak i gjobës apo një pjese të saj nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Duke qenë një dënim, ai nuk mund të jetë i ekzekutueshëm derisa të ketë një vendim gjyqësor të formës së prerë që ta konfirmojë atë. Kur një organ administrativ gjobit individin apo subjektin, kundërvajtesit kanë të drejtë të ankohen në gjykatë, pasi të kenë ezauruar rrugën administrative, dhe vetëm pasi vendimi gjyqësor të ketë marrë formë të prerë, dënimi administrativ, gjoba, bëhet e ekzekutueshme dhe vilet ashtu sikurse e përcakton Kodi i Procedurës Civile. Ekzekutimi paraprak i dënimit administrativ, qoftë edhe i pjesshëm, shkel rregullat e një procesi të rregullt ligjor.

Së dyti, shkel rregullat e ekonomisë së tregut. Parapagimi i gjobës, edhe pse në masën 15 për qind, padrejtësisht, do ta vinte subjektin tatimor në vështirësi ekonomike pasi në varësi të masës së gjobës dhe të fuqisë ekonomike, pagimi paraprak i gjobës mund të ndikojë drejtpërdrejtë dhe në vetë ekzistencën e subjektit tatimor. Kjo do të krionte, në momentin

Së treti, neni 43, paragrafi 2, ka parashikuar që shqyrtimi gjyqësor zhvillohet sipas një procedure të përshejtuar, e cila nuk duhet t'i kalojë 60 ditë. Lehtësisht, mund të konstatohet, që me një ligj të zakonshëm përcaktohen rregulla të procedimit në gjykatë, të ndryshme nga rregullat e procedimit që gjykata ndjek në të gjitha rastet e tjera, të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Nëse ky rregull, duke u vlerësuar si një diskriminim pozitiv, do të ishte i nevojshëm, ai ose duhej të parashikohej në Kodin e Procedurave Administrative ose ligji duhej miratuar me tri të pestat e gjithë anëtarëve të Kuvendit, siç është parashikuar në nenin 81, pika 2 të Kushtetutës. Në të kundërt, ky rregullim bën që të krijohet konflikt midis ligjeve, aq me tepër, ndërmjet një ligji që miratohet me votë të cilësuar dhe një ligji që miratohet me shumicë të thjeshtë.

Do të dëshiroja, gjithashtu, të tërhiqja vëmendjen tuaj, të nderuar deputetë, në lidhje me rrugën e ndjekur për hartimin dhe miratimin e këtij ligji. Nga takimet e shumta që kam patur, me faktorin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, më është pretenduar se nuk është konsultuar si duhet dhe nuk është marrë në konsideratë sa duhet, mendimi i specialistëve dhe i grupeve të interesit. Çmuj se ligje të këtij karakteri janë me pasoja, pozitive ose negative sipas rastit, për krijimin e një klime besimi dhe nxitjeje për biznesin dhe investimet e brendshme dhe të huaja. Kjo klimë duhet të favorizohet në këtë drejtim me masa legjislative dhe organizative, por, gjithmonë, duke përcaktuar mënyra të sakta për vënien përpara përgjegjësive të atyre që bëjnë evazion fiskal. Kjo e fundit duhet të jetë e tillë që t'u garantojë subjekteve nga ana tjetër një proces të rregullt dhe të evitohet qoftë edhe në raste të shkëputura, sjelljet abuzive të administratës shtetërore, të cilat në ndonjë rast mund të sjellin pasoja të pariparueshme.

Të nderuar deputetë,

Unë besoj se ju do të mirëkuptoni kthimin e ligjit për rishqyrtim në Kuvend, dhe se do të bëni rregullimet e nevojshme në të, me qëllim që ligji të përmbushë qëllimin për të cilin do të dalë.

Me respekt,

Alfred Moisiu

President i Republikës